POSTIM ARKIVOR

Mustafa Merlika-Kruja (1887-1958)



SEKSIONI

Figura historike

PERIUDHA

1958 - 1958

Mustafa Merlika Kruja është një figurë e rëndësishme të historisë moderne shqiptare. Karriera e tij politike nis me shpalljen e Pavarësisë në 1912 dhe përfundon me dorëheqjen e tij nga posti i kryeministrit në vitin 1943. Pas largimit nga Shqipëria në shtator 1944 jetoi në mërgim deri sa vdiq në SHBA më 1958, duke u përqendruar në studime historike dhe albanologjike. Gjatë komunizmit u cilësua si kryeministër kuisling por përkujtohet edhe si kryeministri që mbajti të bashkuara trojet shqiptare dhe nuk pranoi t'u dorëzonte hebrenjtë trupave gjermane. La pas një veprimtari të rëndësishme studimore, letërkëmbime dhe një fjalor të humbur; veprat e tij u ribotuan pas vdekjes. Është nderuar me titullin “Honoris Causa” (1942) nga Universiteti i Padovës, “Qytetar Nderi” nga qyteti i Prizrenit (1942) dhe “Nderi i Kombit” (2012) nga presidenti i Republikës me rastin e 100-vjetorit të Pavarësisë. Një bust ngrihet për nder të tij në qytetin e Krujës. Për Mustafa Krujën gjenden dy dosje në arkivin e ish- Sigurimit të Shtetit me një vëllim prej 811 faqesh.

PAVARESIA

EMIGRACIONI POLITIK

ALBANOLOGJIA


Dokumentacioni arkivor

Dokumentacioni arkivor i gjendur për Mustafa Krujën është vlerësuar edhe vetë Sigurimi i Shtetit një pasuri me rëndësi historike si nga vëllimi, ashtu edhe nga larmia e dokumenteve dhe shtrirja në kohë. Të dyja dosjet që i përkasin Mustafa Merlika Krujës kanë një vëllim prej 810 faqesh, por informacione mbi të ka edhe në dosje të protagonistëve të tjerë të asaj periudhe të vënë nën vëzhgimin e ish Sigurimit. Dosja për të është hapur në vitin 1958, disa muaj përpara se ai të ndërronte jetë dhe nuk ka ndonjë përpunim lidhur me të, as informacione të sakta për vendndodhjen dhe veprimtarinë e tij në ato momente. Ka vetëm disa informata, të shpërndara nëpër dosje të tjera, ku Kruja është përmendur. Dokumentacioni është mbledhur në një fashikull, të cilat sipas shënimeve me laps duket se janë marrë nga Drejtoria e Arteve “një sasi dokumentesh të vlefshme. U gjet dosja e korrespondencës private të Mustafa Krujës që ka bamë nga mërgimi me farefisin e tij që nga viti 1923 dhe deri në 1930 si dhe pak letra të viteve 1937-1938.” Dokumentacioni arkivor prej 810 faqesh për Mustafa Krujën në arkivin e AIDSSH-së është përmbledhur në dy dosje: dosja e parë me nr. 363 “Mustafa Merlika (Kruja)”, deklasifikuar nga KDZH me vendimin nr. 11, datë 5.4.2024; dhe dosja e dytë nr. 57 , me “Lista emërore e anëtarëve të Këshillit ët Kryesisë të Partisë Fashiste dhe i Qeverisë së kryesuar nga Mustafa Kruja”, deklasifikuar nga KDZH me vendimin nr. 5, datë 17.5.2023. Dokumentacioni është në tri gjuhë: persisht, shqip, italisht. Dokumentet janë në disa formate: të shkruara me dorë, të përkthyera në shqip apo italisht sipas rastit. Lidhur me natyrën e dokumenteve, ato mund të klasifikohen: letërkëmbime familjare dhe me miqtë, dokumentet historike dhe zyrtare të hartuara në italisht, korrespondencë zyrtare e kohës së pushtimit italian, transkripte të telegrameve, shënime me laps nga Sigurimi i Shtetit lidhur me përmbajtjen e dokumentacionit, lidhur me rëndësinë historike..... Disa dokumente përmbajnë shënime me laps apo me stilolaps që sqarojnë persona të përmendur apo ngjarje të caktuara. Dokumentet datojnë nga vitet 1909-1945. Nga përmbajtje janë dokumente që lidhen me përpjekjet për shkrimin e gjuhës shqipe, për luftimet në Shqipërinë e Veriut. Persona të përfshirë: Refik Bej Toptani; Mahezar Bej Toptani, Ismail Qemal Vlora, Luigj Gurakuqi, Muharrem Bajraktari, Qazim Koculi, Kol Bibë Miraka, Gaqo Gogu, Ernest Këlcyra, Fan Noli, Vasil Andoni, Nuredin Vlora, Konti Ciano, Giovani Giro, Rexhep Mitrovica, etj. Dosja përmban shënime me laps ku shpjegohet se materialet për Mustafa Krujën janë gjetur në Drejtorinë e Arteve dhe përmblidhen disa letra të tij. 1. Dosje nr. 363 Mustafa Merlika Kruja Është hapur me vendimin e datës 21.2.1958. Në vendim përmendet se ai ka qenë pjesë e “Bllokut Kombëtar Indipendet”, pjesë e zbulimit italian. Dosja përbëhet nga fondi personal i korrespondencës së tij dhe nga një pjesë e mirë e dokumentacionit zyrtar gjatë periudhës që ai ka qenë në krye të Qeverisë dhjetor 1941- janar 1943. 1. Dosja nr. 57 “Lista emërore e anëtarëve të Këshillit të Kryesisë të Partisë Fashiste dhe i Qeverisë së kryesuar nga Mustafa Kruja” Është deklasifikuar nga KDZH me vendimin nr. 5, datë 17.5.2023 me 6 faqe. Përmban listën emërore të Këshillit të Epërm Fashist Korporativ dhe disa korrespondenca lidhur me pagesat.

MEDIA #1


Kapakët e dosjes

MEDIA FAQE #1



Kapakët e dosjes

MEDIA FAQE #2



Kapakët e dosjes

INFORMACION

Kapakët e dosjes

FONDI	Të arratisur
STRUKTURA	Ministria e Punëve të Brendshme, Drejtoria e Sigurimit të Shtetit
DOSJA	Nr. 363
	1958
	804
DATA E KRIJIMIT	14.01.1958
GJUHA	Shqip, italisht, persisht
NR. I FLETEVE	
TIPOLOGJIA E DOSJES	Formulare


TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.

MEDIA #2

Ligjëratë e Mstafa Krujes

MEDIA FAQE #1



Ligjëratë e Mstafa Krujes

INFORMACION

Ligjëratë e Mstafa Krujes

FONDI	Të arratisur
STRUKTURA	-
DOSJA	Nr. 363
	1958
	804
DATA E KRIJIMIT	18.03.1940
GJUHA	Shqip
LLOJI I DOKUMENTIT	Ligjëratë e botuar


TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.

MEDIA #3

Raport

MEDIA FAQE #1



COMANDO SUPERIORE CARABINIERI REALI DELL'ALBANIA
Komanda Eprore e Karabinjerve Mbretnorë të Shqipnis
UFFICIO SERVIZIO
Zyre e Sherbimit

REGISTRAZIONE IN ARRIVO

N. 393/2 di prot. Tirana, li 12 aprile 1940 - Anno XVIII
N. ... prot. Tiranë, me ... 19... - Vjeti X...

Risposta al ... del ... n. ...
Përgjegje ... me ... n. ...

OGGETTO : Musulmani GHEGHI e TOSCHI.
SHKURTIMI: ...

Carte annesse: ...
Lidhje: ...

Al la Regia Luogotenenza Generale -Uff.I-
TIRANA

RISERVATO

Gli albanesi toschi residenti in Tirana rilevano che il Senatore MUSTAFA KRUJA, nel suo discorso del 9 corrente al Teatro "Savoia", non fu esatto affermando che il "Ghego" potrebbe essere scelto a lingua ufficiale albanese sia perchè di origine più remota, quindi tradizionale, sia perchè già 3/4 della popolazione lo parlano. Essi sostengono infatti che il loro dialetto, oltre ad essere più antico, ha il pregio di essere più chiaro e privo di vocaboli di origine slava.

APERTURA
13 APR. 1940 XVIII
CORRISPONDENZA

IL GENERALE DI DIVISIONE COMANDANTE
-C.Agostinucci-

ARCHIVIO REGIO
18 APR 19..
Uff.

B-2-9-

Raport

INFORMACION

Raport

FONDI	Të arratisur
DOSJA	Nr. 363
	1958
	804
DATA E KRIJIMIT	12.04.1940
GJUHA	Italisht
LLOJI I DOKUMENTIT	Raport


TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.

MEDIA #4

Letër

MEDIA FAQE #1



Letër

INFORMACION

Letër

FONDI	Të arratisur
DOSJA	Nr. 363
	1958
	804
DATA E KRIJIMIT	15.04.1942
GJUHA	Italisht
LLOJI I DOKUMENTIT	Letër


TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.

MEDIA #5

Telegram

MEDIA FAQE #1



TELEGRAMMA N.01187
IN PARTENZA

Luogotenenza Generale di Sua Maestà il Re Imperatore in Albania

UFFICIO Segr.Gen.

Destinatario: Prof.Carlo ANTI – Rettore Magnifico R. Università – PADOVA

Visione

Tirana, li 18 MAG. 1942 Anno XX 20

OGGETTO: Conferimento laurea ad honorem all'Ecc. Mustafà Kruja –

(TESTO) Dati numerosi precedenti inderogabili impegni che non gli permettono di assentarsi attualmente da Albania (,) Eccellenza Kruja vi sarebbe grato voleste esaminare possibilità rinviare cerimonia conferimento laurea ad honorem a prossimo mese ottobre(.)

Mentre unisco mia preghiera a quella della Ecc. Kruja(,) mi è gradito esprimervi sentiti ringraziamenti per cortese apprezzato pensiero con il quale codesta antica gloriosa Università ha inteso onorare presidente Consiglio Ministri Albania(.)

JACOMONI

ARCHIVIO REGISTRATO

Telegram

INFORMACION

Telegram

FONDI	Të arratisur
DOSJA	Nr. 363
	804
	1958
DATA E KRIJIMIT	18.05.1942
GJUHA	Shqip
LLOJI I DOKUMENTIT	Telegram


TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.

MEDIA #6

Shkrese percjellëse për projektdekretin

MEDIA FAQE #1



MBRETNIJA SHQIPTARE

KRYESIA E KËSHILLIT TË MINISTRAVET

Nr. 1872

Tiranë, më 22 QER 1942 XX

516

Shumë të Shkelqyeshmit
Mëkambësit të Përgjithshëm
të Madhnis së Tij Mbretit Perënduer

_T i r a n ë_

SHKURTIMI:
Mbi dhanjen e nji shperblimi mësuesve qi sherbejnë në viset e lirueme gjatë pushimeve verore.

Këtu ngjit kam nderin me i paraqit Shkelqesis s'Uëj,për Dekretim,Skemë-Dekretin,mbi dhanjen e nji shperblimi prej fr. Shq.200(dyqind)në muej si edhe shpenzimet e udhëtimit për vajtje e këthim,qdo mësuesi a profesori qi ka me u ngarkue gjatë pushimevet verore për me dhanë mësim në kurset e gjuhës Shqipe ku do qi të hapen në viset e lirueme për analfabetë të rritun;i pranuem prej Këshillit të Ministravet me Vendimin e tij Nr.298.datë.20/6/...1942-XX.

Me këte rast,pëlqeni Shumë i Shkelqyeshmi Mëkambës i Përgjithshëm,ndjenjat e konsiderates s'ime ma të naltë.


KRYEMINISTRI :

APERTURA
22 GIU. 1942 XX

ARBSH

Shkrese percjellëse për projektdekretin

MEDIA FAQE #2



REGNO D' ALBANIA
Presidenza del Consiglio dei Ministri

N°.1872

Tirana, li 22 Giugno 1942. XX°

517

Al Serenissimo Luogotenente Generale
di Sua Maestà il Re Imperatore

T i r a n a

Vostra qui accluso per essere decretato lo schema di Decreto relativo alla concessione di un' indennità di Fr.A.200 (duecento) mensili nonchè le spese di viaggio per andata e ritorno, a ogni insegnante o professore che sarà incaricato durante le vacanze estive di dare lezioni nei corsi di lingua albanese ovunque saranno aperti nelle regioni redente per analfabeti adulti; approvato dal Consiglio dei Ministri con la sua deliberazione N°.798 del 20 Giugno 1942. XX°.

Colgo l' occasione ecc.

Il Presidente del Consiglio
F/to M. Kruja

AIBSH

INFORMACION

Shkrese percjellëse për projektdekretin

FONDI	Të arratisur
DOSJA	Nr. 363
	1958
	804
DATA E KRIJIMIT	22.06.1942
LLOJI I DOKUMENTIT	Shkresë
GJUHA	Italisht, shqip


TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.

MEDIA #7

Telegrame

MEDIA FAQE #1



600

SHKELQESËS DHIMITER BERATTI
STRUGË

MANIFESTIMET ME STRUGËN E LIBRUEME TË KUVËNDIT TË PARË TË KULTURES SHQIPTARE JANË DËSHMIJA MA E THELLË E KUJDESJES QE QEVERIJA MBRETNORE USHQEN NDAJ VLLAZNIT TASH MA PËR GJITHMONË TË BASHKUEM ME ATDHEN PIKË KUVËNDIT UROJ SUKSES TË PLOTË I BINDUN SE ME BASHKPUNIMIN E VLEFSHËM QË VËNDET E LIRUEME KAN ME U SJELL KULTURES SHQIPTARE DO TË NXIRREN FRYTET E DISHRUEME PËR ARRITJEN E QËLLIMEVE TË NALTA QI SYNOJNË BASHKIMIN SHPIRTNOR TË GJITH SHQIPTARËVET


MUSTAFA KRUJA

M. Kruja d.r.

AIDSH

Telegrame

MEDIA FAQE #2



601

T e l e g r a m

BASHKIS
PRIZREN

Tue u kthye në Kryeqytet prej udhëtimit t'em të paharrueshëm në viset më të bukura e më t'ambla të kësaj bote qi deri dje i pat gëzue anmiku e sod me ndihmën e Zotit e t'armve të Boshtit po i gzon kush ka pasun të drejtë, e kam për detyrë më i çue përshëndetjen t'eme ma të përzëmërt atij qyteti historik qi pat bujarln me më pamun të denjë për bir në shpirt tue më falun titullin e diplomën e qytetarit të nderit.

MUSTAFA MERLIKA KRUJA

AIDSH

INFORMACION

Telegrame

FONDI	Të arratisur
DOSJA	363
	1909-1958
TIPOLOGJIA E DOSJES	Formulare
HAPËSIRA GJEOGRAFIKE	Shqipëri, Kosovë
LLOJI I DOKUMENTIT	Telegram


TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.

MEDIA #8

Teksti i një telegrami

MEDIA FAQE #1



Mbretnija Shqiptare
Ministrija e P. te Mbrendshme
ZYRA POLITIKE DHE E PERSONELIT

154

P.T.KRYESIS SE KESHILLIT TË MINISTRAVET

_T i r a n ë_

Këtu poshtë kemi nderin t'ju pershkruejmë tekstualisht telegramin Nr.53 Res.datë 23.XII.1941-XX të Prefekturës së Pejës,me lutje që mbi çeshtjen të bahen demarshet e duhuna dhe mundësisht të na njoftohet perfundimi:

"Marrëm lajme se shumë familje të krahinës Tashlixhës e të rretheve të Serbices janë masakrue në këto ditët prej serbve Pikë afer dy mij vetë t'ardhun nga ato krahina kanë mbrrijtë në Mitrovicë për të gjetë strehë Pikë Në Novi Pazar numëri i t'ikunve asht edhe ma i madh.Nga lajmet që na vijnë nga Plava,Tutina e Rozhaja konstatohet se malazezët qi ndodhen në kufi me këto vende janë gjithnji në levizje shifen në pregatitje për ndonji mësymje dhe asht friga se këta mund t'atakojnë krahinat Kufitare Pikë Levizja e serbvet nga një anë dhe ajo e malazezvet nga ana tjetër mund t'u nxjerrin trazime këtyne viseve Pikë Nga ana tjeter lëvizjeve dhe pregatitjeve qi mund të bahen në mal të Zi e në Serbi u ndihmon shumë propaganda e marrëveshtjet qi zhvillojnë malazezët qi ndodhen në Pejë sasija e të cilve arrinë deri në gjashtëmij burra e gra Pikë Kemi konstatue se këto elementa janë tue zhvillue në këto dit me mënyrë të mshefta e indirekte propagandë edhe ndër Shqiptarët tue i predikue këto të mos bashkëpunojnë me Italianët Pikë Serbët e Malazezët e Pejës janë t'armatosun Pikë Në rast të ndonji levizjeje këto kanë për të lujtë një rrol të madh Pikë Të shumta janë demarshet qi ka ba kjo Prefekturë xxxx pranë organeve të Karabinieris e t'Ushtris për të ba një çarmatim radikal,por mjerisht deri më sot e'asht ba kurrgja sepse edhe në qoftë ba ndonji kontrollim asht bamë në mënyrë krejt formale sa që resultati ka qenë negativ e në bazë të këtij resultati karabinerija insiston sekëta elemente nuk kanë armë kurse në të vertetë janë t'armatosun deri në dhambë Pikë Për të qenë në gjendje me perballue ndonji kercenim eventual që mund të bahet kësaj krahine prej çetave serbe,malazeze,kjo Prefekturë e shef te nevojshme të merren sa ma parë këto masa Pikë 1) Të dergohen sa ma shpejt pesqind armë në Plavë,njimij e pesqind për Rozhajën e Tutinë të paktën njimij për Pejën me Rrethe Pikë 2) Të bahet një çarmatim radikal në elementet malazez e serbë Pikë 3)Të merren masa për largimin sa ma shumë të malazezve prej Peje Pikë Për sa i përket xxx xxxx kësaj pikës së fundit kjo Prefekturë u ka dhanë leje kalimi shumë familjeve për të këthye në Mal të Zi e në Serbi me qendrim definitiv por nëse këto ditë organet ushtarake dhe karabinierija e këtueshme nuk po e deshrojnë këtë veprimin t'onë pra kjo vepër e jona asht e ndalueme Pikë Lutemi të merret çeshtja në studim dhe të zgjidhet sa ma parë Pikë"

Ministri i P.te Mbrendshme:
M. Kruja.d.v.

Teksti i një telegrami

INFORMACION

Teksti i një telegrami

FONDI	Të arratisur
DOSJA	Nr. 363
	1958
NUMRI I FAQEVE	804
DATA E KRIJIMIT	23.12.1941
GJUHA	Shqip
LLOJI I DOKUMENTIT	Përshkrim telegrami


TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.

MEDIA #9

Vendim i datës 20.02.1958

MEDIA FAQE #1



APROVOHET
DREJTORI ZBULIMIT POLITIK

Model Nr. 1
TEPËR SEKRET

V E N D I M

Vendim i datës 20.02.1958

INFORMACION

Vendim i datës 20.02.1958

FONDI	Të arratisur
DOSJA	Nr. 363
	1958
	804
DATA E KRIJIMIT	20.02.1958
GJUHA	Shqip
LLOJI I DOKUMENTIT	Vendim


TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.

MEDIA #10

Raport

MEDIA FAQE #1



REPUBLIKA POPULLORE E SHQIPERISE
MINISTRIJA E P. MBRENDESHME

Nr. _____ Te diela mbas dreke me 19 Maj 1948,ne zhteci te Nuredin Vlores/Corso Trieste Nr.54/a mbeit asamblea e b[illit] per nji org.nizim me rund t'[illegible] te bi-sedimeve me drekerit.Delegatet nga kampet paten vajte ne Bagmoli:Dosti e Dilo - Musa Kraja, Arif Fogo, Xhemil Mego, Halim Begeja, Faik Coku, Dr.Vasil Dhimitri, Qazim Frodani, Ismail Sefa, Kit-bat Frasheri, Vasil Andoni, Halil Ma-çi, Zef Logoreci.-

Te gjith kata kishin autorizime perfaqesie te nje numur shokesh.Komentet qe ishin me pare per Nuredinin Vloren me qe Mit-hati ikte per ne Greqi nuk fituan per intrasigjencen e te rijve ballists fanatik te Mit-hatit /Fali e Mboke/.-

Mbledhja qe u zhvillua po nen kryesim e Mit-hatit, deklaroj nji keshille qe do qendroj ne Itali pa kryetar me qe Kryetari u zgjoth po Mit-hati qe mizel ate dite nga Gjenova me Greqi me nji leje te pa caktuar.Pro Mit-hatit qe dhe i plot-fuqishem nuk ka me nevoje as auto-rizim t'i baje keshilla e mbledhje zgjedhje tjera,sic ki-shte ndermend te bejte me Greqi e Siri nga frika e korren-teve kunder.shtare.Ata gjoka per keshilla qe thane se do te qendrojne atje/Itali/nuk ka te drejte te zgjedhe kur nji kryetar tjeter per arsye,gjoke tane kisht e aut[illegible] torizuar per cdo kontakte e marveshje me grupet e tjera per bashkpunim.-

Te gjoser po kete persona,u mbledhen perseri ne shtepi te Nuredin Vlora dhe vendosen bashkpunimin me bllokun dhe zgjedhet si parti monarkiste,me te cilat grupe mund te formohej nji Komitet i perbashket per tra-tativa formimi[illegible] me drekerit.Me ta bllokun [illegible] [illegible] per bashkpunim mga keshi-lla e re,nuk mundi tu jepte kjo pergjigje,pse pa pritur Nuredin Vlora i zemeruar qe nuk u zgjodhe as si nen kry-etar aktiv vrane kesaj keshille,u nigit e shkoj ne Gjeni me gjith[illegible] qe ngarkuar bashke me Dostin per bashk-fjal-met per kete bashkpunim.-

U zgjodhen.-

Kryetar Mit-hat Frasheri
Antare Dr.Vasil Dhimitri — Halil Maçi
" Hasan Dosti — Halil Mezuku
" Nuredin Vlora
Leo Kurti — Ky i fundit absent.-
Vasil Andoni

Nxjere aga inf.dt.5-6-948.-

Raport

INFORMACION

Raport

FONDI	Të arratisur
DOSJA	Nr. 363
	1958
	804
DATA E KRIJIMIT	05.06.1948
GJUHA	Shqip
LLOJI I DOKUMENTIT	Raport


TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.

MEDIA #11

Raport

MEDIA FAQE #1



Mustafa Kruja banon ne Katarraktin e Niagares(pjese Ame
rikane) ai eshte shume i demoralizuar nga kontradiktat qe ekzistojne
ne gjirin e emigracionit reaksionar dhe ka qenur keqe ardhjen për
këtë situate,nga gjendja ekonomike
Mustafaj ka qenur deshiren te nxjere nje revist e cila do kontribuoj
për çështjen e përbashket,por ka theksuar se eshte e pa mundur nga ana
financiare,ka shtuar se për këtë ka kërkuar përkrahjen nga elemente te
ndryshem,por nuk ka gjetur dhe eshte ne pa mundesi ta beje.Flisnte
kunder kreareve te emigracionit te cilet duke vene para çdo gje
je kapriçot e tyre personale dhe deshirat për posita,e kane katandisur
emigracionin Shqiptare ne nje pozite te ulet.

Nxjere ne 4 kopje nga raporti i Agjentit date 7.XII.
nga Punetori Operative Kapiten Idai Shehu 1957
Tirane me 7.XII.1957

Raport

INFORMACION

Raport

FONDI	Të arratisur
DOSJA	Nr. 363
	1958
DATA E KRIJIMIT	07.12.1957
GJUHA	Shqip
LLOJI I DOKUMENTIT	Informatë
PUNETORI OPERATIV	Idai Shehu

TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.

MEDIA #12

Foto

MEDIA FAQE #1



Foto

INFORMACION

Foto

FONDI	Të arratisur
DOSJA	Nr. 363
	1958
NUMRI I FAQEVE	804
DATA E KRIJIMIT	1944
LLOJI I DOKUMENTIT	Foto

TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.